



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:043679
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05526894

K.Dh.Sh.II.nr.1552/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” ShPK nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.513/21, të datës 11.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.518/21, i datës 11.05.2022, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë dhe mbetet në fuqi aktvendimi 01.3.2.2/17203 i datës 08.02.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.518/21, i datës 11.05.2022, të anulohet si i pabazuar në tërësi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.518/21, i datës 11.05.2022 dhe të kthehet lënda përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. nr.01.3.2.2/17203 të datës 08.02.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “Ardi” ShPK – Prishtinë, për shqyrtimin e vendimeve nr. R-2195/12.12.2020, R-19961/25.11.2020 dhe R-21498/17.12.2020 të ZBD Prishtina 3.

Me këtë aktvendim, është konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror, subjektit në procedurë “Ardi” Sh.P.K – Prishtinë i ka kontestuar vlerën e malit lëndor sipas Deklaratave Unike Doganore të lartcekura, ndërsa në proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave kanë cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së tretë të vlerësimit neni 32 paragrafi 2 pika b) dhe metodës së gjashtë të vlerësimit neni 35, të Kodit doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht duke u bazuar në mallra të ngjashme dhe në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 11.05.2022, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa le në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/17203 datë 08.02.2021. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se subjekti në procedurë nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e deklaruar, pasi që edhe pse paditësi ka paraqitur transferet bankare të datës 01.06.2021 dhe 14.06.2021 me status ekzekutuar, të njëjta transfere nuk janë bërë në emër të eksportuesit të mallit lëndor kontestues. Lidhur me këtë fakt përfaqësuesja e të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se përfituesi i këtyre mjeteve monetare “Ding –Lei” nga Kina, është ndërmjetësues siç ndodh rëndom për importet nga Kina, mirëpo ka deklaruar se nuk ka kontratë apo dokument në mes të eksportuesit dhe përfituesit të këtyre mjeteve, për ta provuar – dëshmuar lidhjen e pranuesit të këtyre mjeteve “Ding-Lei” nga Kina, dhe shitësit – eksportuesit Run-Far International Co Limited – China sikurse në faturat dhe DUD-at kontestues R-21195/12.12.2020, R-19961/25.11.2020 dhe R-21498/17.12.2020. Nga kjo gjendje faktike Gjykata e pranon si të drejtë, konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues. Pastaj e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën

e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor Run-Far International Co Limited – China me të dhëna dhe referenca të sakta në urdhërpagesat ndërkombëtare lidhur me faturat e paguara. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provën materiale si faturat e mallit, e njëjta nuk ka arrit të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme, pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor është transaksioni bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar në emër të eksportuesit të mallit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se paditësi nuk ka prezantuar fakte të bazuara që argumentojnë se ka paguar vlerën reale të mallit sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, pasi që urdhërpagesat ndërkombëtare të datës 01.06.2021 dhe 14.06.2021, nuk janë bërë në emër të lëshuesit të faturave - eksportuesit të mallit lëndor Run-Far International Co Limited – China, dhe për këtë mosharmonizim të këtyre dokumentacioneve pala paditëse nuk ka ofruar prova që do të dëshmonte lidhjen ndërmjet ekspertuesit të mallit lëndor Run-Far International Co Limited – China dhe pranuesit të mjeteve financiare nga transferet bankare të datës 01.06.2021 dhe 14.06.2021 “Ding –Lei” nga Kina.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë

të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1552/22, me datë 28.03.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova